

**STATUTI I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“OB SPORTS ADVISORY”SH.P.K.**

**KREU I**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**NENI 1**

Në bazë të ligjit nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, sot më datë **02/06/2021**, me vullnet të lirë, Ortaku:

1. **Olsi Bregu**, i biri i Gramozit lindur më 10.12.1982, në Skrapar, banues në adresën Rr. “Ismail Qemali”, Pallati 18, Kati II, Tiranë, pajisur me pasaportën me nr. BI226522 dhe nr.personal I21210106H;

si themelues i kësaj Shoqërie me Përgjegjësi të Kufizuar, vendosi të hartojë këtë Statut, mbështetur në parimet e mëposhtme:

**KREU II**

**EMRI, FORMA, SELIA, KOHEZGJATJA**

**NENI 2**

**EMRI**

Emri i shoqërisë është “**OB SPORTS ADVISORY**”shpk.

**NENI 3**

**FORMA**

Shoqëria do të ketë statusin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar dhe ortakut do të përballojë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nëshkruara për kapitalin.

**NENI 4**

**SELIA**

Shoqëria e ka selinë e saj në Tiranë, Njësia bashkiake nr.9, Bulevardi Zogu i Parë, Rruga Dëshmorët e Kombit, përballë Ministrisë së Drejtësisë, pall.64, shk.1.

Selia e shoqërisë mund të ndryshohet nëpërmjet vendimit të Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë.

**NENI 5**

**AFATI**



Shoqëria do të ketë kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj me një afat të paktuar.

### **KREU III**

### **O B J E K T I**

#### **NENI 6**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është:  
Ofrimi i shërbimeve ndërmjetësimi dhe agjencisë sportive për futbollistët.  
Importi i veshjeve dhe pajisjeve sportive.

### **KAPITALI**

#### **NENI 7**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100 (njëqind) lekë dhe përbëhet nga nga 1 (një) kuotë e vetme, e nënshkruar nga ortaku.

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose të zvogëlohet sipas vendimeve të Asamblesë së Ortakëve, por asnjherë nuk mund të zvogëlohet nën minimumin ligjor.

#### **NENI 8**


### **MËNYRAT E FITIMIT DHE KALIMIT TË KUOTAVE**

Kuotat e kapitalit të shoqërisë e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Ortakët mund t'u shesin të tretëve kuotat e tyre të kapitalit pjesërisht ose tërësisht, por pasi t'u kenë ofruar për blerje ortakëve brenda shoqërisë me kushte të njëjta nga ato që do j'u ofrohen të tretëve. Oferta u komunikohet me shkrim ortakëve të cilët kanë të drejtën e parablerjes, e drejtë të cilën duhet ta ushtrojnë brenda 30 ditëve nga data e komunikimit, në të kundërt oferta konsiderohet e refuzuar prej ortakëve që gëzojnë këtë të drejtë.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit në QKB.



Kuotat janë të papjestueshme.  
Çdo kuotë jep të drejtën e një vote.

## **KREU IV ORGANET E SHOQËRISË**

### **NENI 9**

Organet drejtuese të shoqërisë janë :

- Asambleja e përgjithshme;
- Administratori.

Fusha e veprimit, përbërja dhe mënyra e funksionimit të organeve drejtuese rregullohet si më poshtë.

## **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME**

### **NENI 10 KOMPETENCAT**

Asambleja e Përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve të çështjeve të mëposhtëme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorit;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të këtij neni;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) të kryejë detyra të tjera të parashikuara nga ligji.

### **NENI 11**

#### **MBLEDHJA E ASAMBLESE**

Asambleja e përgjithshme është organi më i lartë vendimor. Ajo mbledhet sa herë që është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë si dhe për të gjitha rastet e parashikuara në nenin 82 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 për "Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" i ndryshuar.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët ose ortakët. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

## **NENI 12**

### **THIRJA DHE VENDIMARRJA NË ASAMBLE**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë. Njoftimi duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur si më sipër, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur më sipër, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës (shumicë e kualifikuar), për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Për çështjet e tjera të renditura në nenin 11 të këtij Statuti, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

Të gjitha vendimet e Asamblesë regjistrohen në procesverbal i cili përmban datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit.

## **ORGANI ADMINISTRATIV**

### **NENI 13**

Administratori i parë i shoqërisë është z. Olsi Bregu, pajisur me pasaportën me nr. BI226522 dhe nr.personal I21210106H.

### **NENI 14**

#### **KOMPETENCAT**


Asambleja e Përgjithshme emëron administratorin e shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje.

Administratori ka këto kompetenca:

a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) të përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) të kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe



të librave kontabël të shoqërisë;

ç) të përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, t'i paraqesi këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) të krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) të kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) të raportoj përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj.

Administratori është kompetent edhe për të:

- realizuar mbledhjen e asamblesë duke njoftuar ortakët me shkrim jo më vonë se 7 ditë më parë;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozuar rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme.

## **KREU V PRISHJA E SHOQËRISË**

### **NENI 15**

Shoqëria priset:

a) me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;

b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;

c) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në QKB;

ç) në rast se objekti bëhet i porealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare.

Me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi, prishja e shoqërisë sjell hapjen e procedurave të likuidimit. Gjate fazes së likuidimit emrit të shoqërisë i shtohet pjesa "Ne likuidim" që shenohet në të gjitha dokumentet që shoqëria nxjerr gjate kesaj perjudhe.

Likuiduesi i emeruar nga Asambleja e Përgjithshme, kërkon çregjistrimin e shoqërisë pranë QKB, pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura të shoqërisë.



## **VITI FINANCIAR**

### **NENI 16**

Ne përputhje me ligjin, shoqëria do të ketë një regjister në të cilën mbahen bilancet vjetore, raporte financiare vjetore dhe çdo kërkesë tjetër ligjore.

### **NENI 17**

Viti financiar i shoqërisë fillon në 1 janar të çdo viti kalendrik dhe përfundon në 31 dhjetor të po këtij viti me përjashtim të vitit të regjistrimit ku viti financiar fillon në datën e regjistrimit të shoqërisë dhe përfundon në 31 dhjetor.

## **DIVIDENTËT**

### **NENI 18**

Pas miratimit të bilancit vjetor dhe shpërndarjes së të ardhurave, Asambleja përcakton shumën që do të ndahet si dividente, bazuar në kuotat që zoteron çdo ortak.

## **PARASHIKIME PERFUNDIMTARE**

### **NENI 19**


Shoqëria konsiderohet e krijuar në përputhje me nenet e këtij statuti dhe aktit të themelimit dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Shoqëria ka vulën e vet në të cilën shkruhet emri i shoqërisë, numri i regjistrimit të subjektit dhe viti i themelimit.

Për ato që nuk janë parashikuar në këtë statut zbatohen dispozitat e ligjit. Statuti është hartuar në 2 (dy) kopje origjinale me të njëjten fuqi ligjore.

## **THEMELUES**

### **OLSI BREGU**

Handwritten signature of Olsi Bregu in blue ink, consisting of a cursive script above a large, stylized circular flourish.

**Dt. 02.06.2021**